

3. AUDITIMI I BRENDSHËM DHE OPINIONI I INSPEKTORIT TË PËRGJITHSHËM

Auditimi i brendshëm në Bankën e Shqipërisë realizohet nga Departamenti i Kontrollit. Objektiv i kryesor i tij është të sigurojë mbarëvajtjen e zbatimit të ligjeve dhe akteve nënligjore në veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë. Funkcioni i auditimit të brendshëm u siguron Administratorëve të Bankës dhe Këshillit Mbikëqyrës, në mënyrë periodike dhe të pavarur, verifikimin dhe vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, duke testuar kontrollet dhe procedurat e caktuara, por duke mos qenë një zëvendësues i tyre.

3.1. ZHVILLIME TË RËNDËSISHME NË AKTIVITETIN E AUDITIMIT TË BRENDSHËM GJATË VITIT

A. Vënia në zbatim e Politikës së Auditimit të Brendshëm

Procesi i shqyrtimit dhe i miratimit të Planit vjetor të Auditimit të Brendshëm në Bankën e Shqipërisë, u realizua në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Plani vjetor për vitin 2018 u hartua nga Departamenti i Kontrollit dhe Inspektori i Përgjithshëm dhe iu paraqit për shqyrtim Komitetit të Auditimit. Më tej, ky plan i dakorduar nga Komiteti i Auditimit, u miratua nga Këshilli Mbikëqyrës me vendimin nr.16, datë 07.02.2018.

B. Hartimi i planit vjetor të auditimit në sistemin e automatizur Pentana bazuar në metodologjinë e aprovuar të vlerësimit të rrezikut

Plani i propozuar për vitin 2019, u bazua në procesin e Vlerësimit të Rrezikut, për qëllime auditimi, nëpërmjet aplikimit me sistemin Pentana. Planifikimi i bazuar në rrezik nëpërmjet këtij sistemi, rrit cilësinë e planifikimit bazuar në rreziqet e identifikuar gjatë auditimit dhe gjatë përditësimit të universit të auditimit me rreziqet e ardhura nga mjedisi i jashtëm, bazuar edhe në kërkesat e vlerësuesve të jashtëm.

Duke filluar nga viti 2017, Departamenti ka mundur hartimin e planit të auditimit të bazuar plotësisht në rrezik, në përputhje edhe me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm.

C. Marrëdhëniet me njësinë e Administrimit të Rrezikut Operacional (ARO)

Bashkëpunimi me njësinë ARO është i vazhdueshëm. Njësia vë në dispozicion të grupeve të auditimit (inspektorëve të kontrollit) listën e rreziqeve operacionale që janë identifikuar dhe raportuar nga departamentet e Bankës periodikisht



dhe monitorohen nga ARO. Ndërkohë, në përfundim të çdo angazhimi, Departamenti i Kontrollit vë në dispozicion të Njësisë ARO raportet e auditimit, vlerësimin e rrezikut të funksionit dhe gjetjeve, dokumentacionin mbi proceset-kontrollet-rreziqet e testuara gjatë auditimeve, si dhe çdo informacion tjetër apo incident që mund t'i vlejë procesit të administrimit të rrezikut operacional në vazhdimësi.

Gjithashtu, Departamenti i Kontrollit raporton periodikisht rreziqet operationale që lidhen me vetë funksionin e auditimit të brendshëm.


D. Implementimi i rekomandimeve të vlerësuesve të jashtëm dhe rezultatet e vlerësimit të brendshëm

Në vijim të vlerësimit të jashtëm të cilësisë së aktivitetit të Auditimit të Brendshëm (External Quality Assessment), realizuar nga Banka Qendrore e Holandës në maj të vitit 2015, Departamenti i Kontrollit, në fund të vitit 2017, ka realizuar angazhimin e vetëvlerësimit të cilësisë së Auditimit të Brendshëm (Internal Quality Assessment).

Tabela në vijim tregon situatën në fund të vitit 2018, lidhur me rekomandimet e vlerësuesve të Jashtëm (EQA) realizuar nga Banka Qendrore e Holandës dhe rezultatet e angazhimit të Vetëvlerësimit të Auditimit të Brendshëm:

Grafik 44. Vlerësimi i cilësisë së auditit të brendshëm (EQA, 2015) dhe vetëvlerësimi i cilësisë (2017) dhe ai i vlerësimit aktual.

Nivelet e përputhshmërisë sipas EQA	Standardet e vlerësuara gjatë EQA sipas nivelit të përputhshmërisë (2015)	Statusi i angazhimit të vetëvlerësimit të cilësisë së AB në 2017	Statusi i aktual pas vlerësimit të fundit 2018
Nuk përputhet	14	0	0
Përputhet pjesërisht	29	16	13
Përputhet	61	88	91
TOTALI	104	104	104



Sipas paraqitjes së mësipërme, vetëm 12.5% e standardeve (13 standarde) nuk janë plotësisht të zbatuara (në përputhje me praktikën më të mirë të parashikuar nga IPPF e Institutit Ndërkombëtar të Audituesve të Brendshëm dhe janë në planet e veprimtimit të Departamentit për t'u realizuar).

TREGUES TË PËRGJITHSHËM MBI DEPARTAMENTIN E KONTROLLIT


Në përputhje me ligjin "Për Bankën e Shqipërisë", Statutin e Bankës së Shqipërisë, politikën dhe rregulloren e Auditimit të Brendshëm, dhe rregulloren



e Komitetit të Auditimit, struktura e Departamentit të Kontrollit paraqitet sipas organigramës së mëposhtme, me qëllim sigurimin e ruajtjes së objektivitetit, pavarësisë, integritetit të informacionit, përdorimit eficient të burimeve dhe efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm në Bankën e Shqipërisë.

A. Struktura organizative e Departamentit të Kontrollit

Struktura organizative e drejtuar nga Inspektori i Përgjithshëm jepet në vijim:



B. Rritja profesionale e stafit dhe trajnimi i vazhdueshëm

Në funksion të përmbushjes së objektivit strategjik për rritjen profesionale të audituesve të brendshëm, inspektorët e kontrollit janë përfshirë në programe trajnimi për auditimin e brendshëm dhe për menaxhimin e rrezikut të ofruara nga bankat qendrore, dhe njëkohësisht kanë ndjekur programe individuale për zhvillimin e tyre profesional dhe për dhënien e provimeve profesionale për anëtarësime/certifikime pranë institucioneve ndërkombëtare në fushën e financës dhe auditimit. Inspektorët e kontrollit kanë vijuar ndjekjen e programeve për certifikimet profesionale ACCA, CIA, CISA⁴², si dhe kanë ndjekur orët minimale të detyrueshme për mirëmbajtjen e këtyre titujve.

Tabelë 9. Statusi i kualifikimeve të stafit të Auditimit të Brendshëm

Programi i kualifikimit dhe ngritjes profesionale të stafit	
Inspektor të kualifikuar për auditim CIA	1 inspektor (1 në proces)
Inspektor të kualifikuar për auditime specifike të investimeve CIDA	2 inspektorë
Inspektor të kualifikuar për raportimin financiar ACCA	2 inspektorë (2 në proces)
Inspektor në proces kualifikimi për auditim IT CISA	1 inspektor

⁴² ACCA – Association of Chartered Certified Accountants (Shoqata e Audituesve të Certifikuar).
CIA – Certified Internal Auditor (Auditues i Brendshëm i Certifikuar).
CISA – Certified Information Systems Auditor (Auditues i Certifikuar i Sigurisë së Informacionit).



ANGAZHIMET E KRYERA GJATË VITIT 2018 DHE PROBLEMATIKAT KRYESORE TË EVIDENTUARA

Angazhimet e auditimeve të kryera gjatë vitit 2018 janë fokusuar në: (i) dhënien e opinionit mbi mjaftueshmërinë e kontrolleve të brendshme të vendosura nga Drejtimi për funksionet/proceset e audituara, përfshirë dhe aplikacionet mbështetëse për kryerjen e aktiviteteve; (ii) angazhime të tjera audituese dhe joaudituese të paplanifikura me kërkesë të veçantë nga Administratorët apo institucione të tjera jashtë Bankës.

Gjatë vitit 2018 u adresuan gjithsej 37 rekomandime të rezultuara nga 10 angazhime auditimi për dhënie sigurie. Rekomandimet kanë adresuar kryesisht nevojën për përmirësimin e proceseve (49%), rishikimin e bazës rregullative (26%) dhe të tjera mbi zbatimin e bazës rregullative.

Gjetjet dhe rekomandimet për secilin prej auditimeve të realizuara gjatë kësaj periudhe janë adresuar fillimisht pranë drejtuesve të njëjësive për komente dhe më pas pranë Administratorëve të Bankës së Shqipërisë.

3.2. ADMINISTRIMI I RREZIKUT OPERACIONAL

Administrimi i Rrezikut Operacional është një nga funksionet më të reja në Bankën e Shqipërisë. Në vitin 2015, Banka e Shqipërisë filloi projektin për ngritjen e këtij funksioni, bazuar në standardet ndërkombëtare të Administrimit të Rrezikut, si dhe në praktikat më të mira të bankave qendrore. Në vitin 2016 u finalizua krijimi i funksionit të administrimit të rrezikut operacional në Bankën e Shqipërisë.

Objektivi kryesor i Administrimit të Rrezikut Operacional është: të miradministrojë pasiguritë dhe rreziqet e mundshme që shoqërojnë veprimtarinë e Bankës; të informojë në çdo kohë Administratorët; të ndihmojë procesin e vendimmarrjes mbi rreziqet që mund të pengojnë arritjen e objektivave të Bankës së Shqipërisë, apo të kenë ndikime negative financiare dhe/ose reputacionale.

A. Ecuria e administrimit të rrezikut operacional gjatë vitit 2018

Në vitin 2018, Njësia e Administrimit të Rrezikut Operacional ka vazhduar rishikimin dhe monitorimin e rreziqeve të identifikuar me njësitë e Bankës, dhe ka hartuar raporte periodike për Administratorët, Komitetin e Auditimit dhe Këshillin Mbikëqyrës, mbi rezultatet dhe analizën e ekspozimit të Bankës ndaj rrezikut operacional.

Gjatë vitit 2018, përparësi i është dhënë evidentimit dhe monitorimit periodik të ngjarjeve/rreziqeve të kategorizuara si "mashtim" (*fraud*) për të gjitha proceset e Bankës, bazuar në praktikat e evidentuara nga bankat qendrore (IORWG - *International Operational Risk Working Group*). Për të gjitha njësitë



organizative të bankës janë evidentuar 34 rreziqe të klasifikuara në kategorinë "FRAUD" (mashttrim).

Viti 2018 mund të konsiderohet si konsolidimi dhe maturimi i funksionit të administrimit të rrezikut operacional.

Realizime në vitin 2018

- Me miratimin e nivelit të tolerancës ndaj rrezikut operacional me vendimin nr.18, datë 29.3.2017, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, për trajtimin e të gjitha rreziqeve të mbetura (reziduale), të cilat u klasifikuan "Të larta" dhe "Të mesme", njësia ARO ka kryer proceset periodike të rivlerësimit të Rreziqeve Operacionale bazuar në raportimet periodike të njëjësive, si dhe rishikimin e të gjitha proceseve të realizuara në nivel banke. Vlerësimi periodik ndihmon në identifikimin dhe trajtimin e rreziqeve të ndodhura sidomos për proceset e vlerësuara me rrezik 'të mesëm' dhe 'të lartë'.
- Miratimi i planeve të veprimit nga Administratorët, të cilat u hartuan nga njësia ARO, në bashkëpunim me të gjitha njësitë e përfshira. U hartuan në total 27 plane veprimi dhe 5 tregues kyç rreziku për minimizimin e 59 rreziqeve operacionale të klasifikuara si "të larta" dhe "të mesme".
- Rishikimi dhe rivlerësimi periodik i databazës së rreziqeve operacionale. Njësia ARO zhvilloi takime me të gjitha njësitë, për të rishikuar databazën e rreziqeve operacionale. Kjo fazë është mbështetur edhe në të dhënat e databazës më të fundit të rreziqeve operacionale të dërguara nga IORWG. Në përfundim, Databaza e Rrezikut Operacional ka evidentuar në total 313 rreziqe operacionale, nga të cilat 304 janë rreziqe specifike dhe 9 rreziqe me natyrë gjithëpërfshirëse.
- Rishikimi i databazës së proceseve të realizuara. Gjatë kësaj faze, u rishikuan gjithsej 409 procese/nënproceset për 23 funksione të shpërndara sipas nivelit të përgjegjësisë për njësitë dhe komitetet e Bankës së Shqipërisë.

B. Vlerësimi i nivelit të Administrimit të Rrezikut Operacional nga ekspertët e huaj

Vlerësimi i nivelit të Administrimit të Rrezikut Operacional kryhet bazuar në metodologjinë e përdorur nga Grupi Ndërkombëtar i Punës për Rrezikun Operacional (IORWG) për bankat qendrore, pjesë e të cilit është edhe Banka e Shqipërisë.

Kjo organizatë është krijuar në tetor 2005 dhe zhvillon e drejton procesin e Menaxhimit të Rrezikut Operacional për Bankat Qendrore. Aktualisht ka të anëtarësuar 96 banka qendrore dhe autoritete mbikëqyrëse dhe monetare. Banka e Shqipërisë u anëtarësua pranë kësaj organizate, në korrik të vitit 2015. Në vijim të këtij procesi, progresi i nivelit të maturitetit të Administrimit të Rrezikut Operacional në BSH ka kaluar nga 'ad-hoc' në 'i menaxhuar' dhe ishte në tejkallim të pritshmërive të objektivave të Bankës së Shqipërisë, duke kapërcyer nivelin 'bazik'.




Aktualisht, në këtë nivel vlerësohen shumica e bankave qendrore që kanë të paktën mbi 5 vjet të konsoliduar funksionin e administrimit të rrezikut.

AD-HOC	BAZIKE	I MENAXHUAR	I AVANCUAR	I MATURUAR
<61%	≥61%	≥69%	≥86%	≥94%

Pas shprehjes së tolerancës për rrezikun operacional nga Këshilli Mbikëqyrës, hartimin dhe miratimin e planeve të veprimit pranë Administratorëve, rishikimin dhe rivlerësimin periodik të databazës së rreziqeve operationale, niveli i maturitetit gjatë vitit 2017, pati një rritje të konsiderueshme në nivelin 69.22% (nga 49.19% në fund të vitit 2016). Niveli aktual i maturitetit i vlerësuar për vitin 2018 është 70.68%, bazuar në ecurinë e procesit të ndjekjes së planeve të veprimit dhe vlerësimit të rreziqeve të raportuara periodikisht nga njësitë. Ky nivel është plotësisht në përputhje me objektivat afatmesëm të funksionit të ARO-s në Bankën e Shqipërisë.


Vlerësimi bëhet periodikisht bazuar në matricën e vlerësimit të IORWG, e cila përcakton dizejnimin e proceseve dhe sistemeve të kontrollit që mbulojnë këto procese, mënyrën dhe strukturën e organizimit, raportimin, rezultatet pas menaxhimit të rrezikut dhe kulturën e rrezikut, e cila është një sfidë që kërkon monitorim, koherencë dhe rritje të ndërgjegjësimit të vazhdueshëm.



C. Funksioni i sinjalizuesit në Bankën e Shqipërisë

Në ndihmë të procesit të Administrimit të Rrezikut Operacional ka ardhur edhe konsolidimi i funksionit të sinjalizimit. Bazuar në ligjin nr. 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve", kjo strukturë ka për qëllim:

- të parandalojë dhe të godasë korrupsionin në Bankën e Shqipërisë;
- të nxisë sinjalizimet mbi veprimet ose praktikatat e dyshuara të korrupsionit;



- c) të mbrojë individët që sinjalizojnë veprimet ose praktikat e dyshuara të korrupsionit në vendin e tyre të punës.

Me miratimin e rregullores "Për hetimin administrativ të sinjalizimit, për mbrojtjen e konfidencialitetit dhe për mbrojtjen nga hakmarrja në Bankën e Shqipërisë", në muajin dhjetor 2017, të gjitha njësitë e Bankës së Shqipërisë u njohën me rregulloren, e cila është e publikuar dhe është e aksesueshme nga çdo punonjës.

Viti 2018 ka funksionuar me bazën rregullative të plotë dhe të gjithë udhëzuesit (anekset) dhe mjetet e nevojshme për t'i mundësuar stafit sinjalizimin e rasteve të dyshimta.

D. Menaxhimi i Vijueshmërisë së Veprimtarisë në Bankën e Shqipërisë (BCM)⁴³

Banka e Shqipërisë ngriti grupin e punës për projektin "Hartimi dhe implementimi i programit të Menaxhimit të Vijueshmërisë së Veprimtarisë në Bankën e Shqipërisë". Në vijim të punës të realizuar, projekti ndodhet në fazën finale të përfundimit të angazhimit.

Ky projekt u realizua bazuar në infrastrukturën më të përditësuar të Bankës dhe është hartuar i tillë që të përditësohet dhe të mirëmbahet periodikisht me të gjitha ndryshimet.

Qëllimi i këtij projekti është që nëpërmjet hartimit të kuadrit të nevojshëm rregullativ, në rast të ndërprerjeve operacionale gjatë një krize/emergjence, të mbështesë Bankën në përpjekjet e saj për të përmirësuar aftësinë reaguese, të sigurojë vazhdimësinë e proceseve kritike, si dhe të rimëkëmbë veprimtarinë normale të aktivitetit të Bankës sa më shpejt të jetë e mundur.

Aktet rregullative të hartuara janë bazuar në Standardin BS 25999 dhe në praktikat më të mira në fushën e Menaxhimit të Vijueshmërisë së Veprimtarisë (BCM). Standardi BS25999 është gjerësisht i pranuar si standardi bazë për hartimin dhe implementimin e një Programi efektiv MVV dhe është i aplikueshëm për të gjitha organizatat (duke përfshirë industrinë dhe sektorët e tyre).

Standardi siguron një kornizë të praktikave më të mira me qëllim minimizimin e pasojave negative gjatë ngjarjeve të padëshiruara, të cilat mund të shkaktojnë ndërprerjen e veprimtarisë. Bazuar në këtë standard, "Menaxhimi i Vijueshmërisë së Veprimtarisë (MVV) është një proces i orientuar nga aktiviteti, i cili vendos një kuadër rregullativ strategjik dhe operacional të përshtatur sipas nevojave që:

- përmirëson në mënyrë proaktive aftësinë rimëkëmbëse të organizatës ndaj ndërprerjeve operacionale, të cilat e bëjnë të paaftë për të përmbushur objektivat kryesorë;

⁴³ MVV (BCM) – Menaxhimi i Vijueshmërisë së Veprimtarisë (Business Continuity Management).



- siguron një metodë rimëkëmbjeje të aftësisë së organizatës për të ofruar produktet dhe shërbimet në kohën dhe cilësinë e dakorduar pasi ndodh ndërprerja e aktivitetit;
- ofron një aftësi të provuar për të menaxhuar ndërprerjen e aktivitetit dhe për të mbrojtur reputacionin e organizatës.



4. BURIMET NJERËZORE

Zhvillimi i burimeve njerëzore, në përputhje me objektivat, strategjinë dhe zbatimin e politikave përkatëse të Bankës, synon të krijojë një mjedis pune të përshtatshëm dhe motivues, që i shërben jo vetëm rritjes profesionale të punonjësve, por dhe përmirësimit të vazhdueshëm të proceseve administrative të institucionit.


Në përputhje me objektivat strategjike afatmesëm të Bankës, administrimi i kapaciteteve njerëzore është fokusuar në përvetësimin dhe zbatimin në vazhdimësi të praktikave më të mira të menaxhimit të burimeve njerëzore që aplikohen në institucione të ngjashme në Bashkimin Evropian. Ndjekja e politikave dinamike të punësimit, menaxhimit dhe promovimit në karrierë të stafit, për një organizim strukturor profesional dhe fleksibël, mbetet në vijimësi prioritet i Bankës. Gjithashtu, racionalizimi i strukturës organizative dhe përmirësimi i efektivitetit të institucionit, në linjë me objektivat strategjike të tij dhe kuadrin rregullativ përkatës, janë qëllimi kryesor i këtyre politikave.

Menaxhimi efikas i burimeve njerëzore kërkon përshtatjen e infrastrukturës rregullative të institucionit me standardet më të mira, duke krijuar në vazhdimësi mundësi promovimi për punonjësit me eksperiencë profesionale, si dhe duke synuar gjithmonë motivimin e punonjësve dhe rritjen e efektivitetit në punë. Përmes politikave për rritjen e motivimit profesional, është synuar ruajtja e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë së stafit, e cilësuar si një ndër sfidat kryesore me të cilat përballen ditët e sotme bankat qendrore.

Përfaqësimi gjinor i stafit, në nivel drejtues dhe profesional, është i ekuilibruar. Raporti i femrave ndaj meshkujve në totalin e punonjësve është 59% - 41%, ndërkohë që ky raport në nivel drejtues është 58% - 42%.

Në vitin 2018, në kuadër të rikonceptimit dhe të rolit të disa njësisve të Bankës, u realizuan disa ndryshime të strukturës organizative. Këto ndryshime synuan përmirësimin dhe forcimin e disa proceseve të rëndësishme, si dhe përshtatjen më të mirë të strukturave të këtyre njësisve të Bankës me detyrat specifike, që burojnë nga objektivat dhe veprimtaria e institucionit.


Grafik 46. Raporti femra/meshkuj në drejtim



Burimi: Banka e Shqipërisë.



Grafik 47. Shpërndarja e punonjësve sipas arsimit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Një kujdes i veçantë i është kushtuar edhe kombinimit të stafit profesional me përvojë me stafin e ri. Mosha mesatare e stafit është 43 vjeç, ndërkohë që rreth 88% e punonjësve në Bankë janë me arsim të lartë. Vlen të theksohet se 57% e tyre kanë përfunduar studime pasuniversitare në nivel Master/PhD, si dhe kanë përfutur certifikata profesionale të njohura nga institucione ndërkombëtare. Rreth 37% e punonjësve kanë kryer studime pasuniversitare brenda vendit, ndërsa 20% e tyre kanë kryer studime pasuniversitare në institucione akademike prestigjioze jashtë vendit.

Një aspekt i rëndësishëm i politikave të burimeve njerëzore është edhe identifikimi i kapaciteteve profesionale dhe ndërpersonale, si dhe përdorimi i tyre në funksion të trajnimit dhe zhvillimit të stafit, i cili është bërë i mundur nëpërmjet realizimit të

trajnimeve profesionale, brenda dhe jashtë vendit. Pjesëmarrja e stafit në këto trajnime të specializuara, të organizuara nga banka të ndryshme qendrore, institucionet financiare ndërkombëtare (IFN) apo të tjera, përveç rritjes së njohurive profesionale, i shërben stafit të Bankës edhe për shkëmbimin e përvojave profesionale dhe menaxheriale me përfaqësuesit e institucioneve të tjera financiare.

Pjesëmarrja më e lartë në trajnime me 46% është kryer në banka qendrore evropiane si: Banka e Gjermanisë, Banka e Italisë, Banka e Çekisë, Banka e Holandës, Banka e Francës, Banka e Polonisë, Banka Qendrore Evropiane etj. Trajnimet e kryera nga institucione financiare ndërkombëtare përbëjnë 23% të pjesëmarrjeve dhe më konkretisht në: Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN), BERZH, BIS, si dhe me 28% pjesëmarrje në trajnime të kryera në bashkëpunim me organizatorë të tjerë si: Komisioni Evropian, EBA, Eurostat, IFC, JP Morgan, CEF etj.

Krahasuar me vitet e shkuara, në vitin 2018, vihet re një dyfishim i pjesëmarrjeve trajnuese brenda vendit, si pasojë e nismave të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë për trajnimin e stafit drejtues (aktiviteti me Federal Reserve (FED)) si dhe një rritje e lehtë e numrit të pjesëmarrjeve trajnuese të zhvilluara jashtë vendit. Pjesa më e madhe e trajnimeve profesionale në vitin 2018 janë realizuar në fushën e Mbikëqyrjes Bankare (10.9%), Politikës Monetare (10.0%), Bankingut Qendror (10.0%) si dhe Operacioneve Monetare (9.2%). Pjesa tjetër e trajnimeve është zhvilluar në fusha si: auditimi i brendshëm, çështje të emisionit dhe administrimit të parasë, statistika, kontabilitet edhe financë, ekonomi dhe modelim etj. Duhet theksuar se numri më i madh i trajnimeve profesionale është i fokusuar drejt ndërtimit të kapaciteteve institucionale të bankës qendrore për përmbushjen e funksioneve të saj kryesore.

